



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE**

Nr. 1240/1 prot.

Tiranë më 01.08.2018

Lënda: Mendim mbi një projekt marrëveshje

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr.1055/8 Prot., datë 30.07.2018, në lidhje me projekt marrëveshjen "Mbi krijimin e bashkëpunimit operacional ndërmjet Agjencisë Europiane për Menaxhimin e Bashkëpunimit Operacional në Kufijtë e Jashtëm të Shteteve Anëtare të Bashkimit Europian (FRONTEX) dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Shqipërisë", Zyra e Komisionerit vlerëson se në tërësi është hartuar konform parashikimeve të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.

Nisur nga praktika e ndjekur në raste të marrëveshjeve të ngjashme të përcjella për mendim nga ana juaj, sugjerojmë që në pikën 7 të projekt marrëveshjes të parashikohen afate konkrete për mbajtjen dhe ruajtjen e të dhënave personale që synohen të transferohen në kuadër të kësaj marrëveshjeje, në zbatim të nenit 5/1/d të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar dhe nenit 5/1/e të Rregullores Europiane për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (GDPR), si dhe mundësia e shkatërrimit të të dhënave në rast të përfundimit të marrëveshjes.

Gjithashtu, referuar pikës 7, sugjerojmë që të parashikohet edhe detyrimi i palëve për të marrë masat e nevojshme për sigurinë e të dhënave personale, në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar dhe nenit 32 të GDPR-së.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

